



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 362/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesuese, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arjeta Rexhepit nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 0402D/03R, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa A.nr 362/2019, e datës 09.10.2019, e parashtruar nga Arjeta Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja që të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin 0402D/03R në shkollën fillore “Selami Hallaqi” Gjilan.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.10.2019, ka pranuar një ankesë Anr.362/2019, nga Arjeta Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), nga Komuna e Gjilanit, në të cilën pretendohet se në vendvotimin me nr. 0402D/03R, është bërë numërimi në disa pika, ndërsa bartja është marrë vetëm nga një pike e që është gabim i fazës së numërimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankesë atakohet rezultatit i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me

numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 362/2019 më datën 10.10.2019

Kryesues i Panelit
Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.